



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Komisioneri

Nr. 831/3 Prot.

Tiranë, më 11/5/2012

**Lënda:** Rekomandim për "Drejtoria e Përgjithshme - UKT" Tiranë

**REKOMANDIM**  
Nr. 12, datë 11/05/2012

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit "Drejtoria e Përgjithshme - UKT" Tiranë

**KONSTATOVA**

Nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit "Drejtoria e Përgjithshme - UKT" Tiranë me objekt:

- Mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale për subjektet e të dhënave personale që i përkasin kategorisë "Konsumatorë".
  - Verifikimi i ligjshmërisë dhe i përputhshmërisë së përpunimit të të dhënave personale për kategorinë "konsumatorë", bazuar në nenin 5 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".
  - Verifikimi i procedurave të prodhimit dhe shpërndarjes së faturave të konsumit mujor të ujit për subjektet e të dhënave personale të kategorisë "konsumatorë"
  - Verifikimi i masave që ka marrë kontrolluesi lidhur me sigurinë e të dhënave personale të kategorisë "konsumatorë" bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi procesverbalin e kontrollit administrativ, pretendimet e kontrolluesit si dhe provat e administruara vëren se:

Faturat e konsumit mujor të ujit për kategorinë e subjekteve të të dhënave "konsumatorë" (kryesisht konsumatorët që banojnë në pallate), shpërndahen të pa mbyllura, lihen pranë shkallëve dhe janë të aksesueshme nga kushdo.

Shpërndarja e faturave të konsumit të ujit në ambiente të hapura (në shkallët e pallateve,hyrjet pallateve etj) të pa mbyllura në zarf në kuptim të ligjit nr. 9887,datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” përben përhapje të të dhënave personale.

Mbrojtja e të dhënave personale të subjekteve që i përkasin kategorisë “konsumatorë” është një detyrim i rëndësishëm që ka kontrolluesi për të ruajtur balancën ndërmjet të drejtës për të përcaktuar përdorimin e të dhënave të konsumatoreve dhe interesave të tij të biznesit.

Konsumatorët presin që të dhënat personale dhe informacionet që përmbajnë faturat e konsumit mujor të ujit të trajtohen në mënyrë konfidenciale nga kontrolluesi, duke përfshire këtu dhe shpërndarjen e faturave të konsumit mujor të ujit, duke garantuar që të mos ketë akses të pakontrolluar. Aksesit për këto fatura është e drejte vetëm e konsumatorit në adresën e të cilit drejtohet kjo fature. Subjektet e të dhënave personale të kategorisë “konsumatorë” duhet të sigurohen që kontrolluesi ka mënyra të sigurta të ruajtjes dhe përhapjes së të dhënave të tyre.

Në këto kushte vlerësoj se është shkelur neni 27 pika 1 e ligjit nr. 9887,datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”...*“Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi”.*

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

### REKOMANDOJ

- Në zbatim të nenit 27 pika 1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” deri me datë 01.01.2013 të merren masat e nevojshme për zarfimin e faturave të konsumit të ujit që i përkasin subjekteve të të dhënave personale të kategorisë “konsumatorë”.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI  
**FLORA ÇABEJ (POGAÇE)**

